



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

Nr. 6357 Prot.

Korçë, më datë 01.12 2016

**NJOFTIM PËR PARAQITJE DOKUMENTACIONI**

Në zbatim të ligjit nr. 171/2014 “Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ligjit nr. 63/2016 “Për një ndryshim në ligjin nr. 171/2014 “Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve, të VKM-së nr. 337/2015 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve” dhe të VKM-së nr. 814, datë 16.11.2016 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 337, datë 22.04.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, Bashkia Korçë njofton të gjithë përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, të paraqesin në bashki dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kërkesën sipas së cilës kërkojnë të pajisen me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, për tokën që e kanë marrë në përdorim nga komisionet e ndarjes së tokës;
- b. Planvendosjen e secilës ngastër që kanë në përdorim, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët;
- c. Çertifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile e njësisë së qeverisjes vendore, ku të pasqyrohet numri i anëtarëve të familjes përfituese ose individi, në favor të së cilit do të lëshohet akti i marrjes së tokës në pronësi, sipas gjendjes më 1 gusht 1991, me ndryshimet deri më 1 tetor 1992, të cilët nuk kanë ndryshuar vendbanimin e tyre që prej kësaj date;
- d. Dokumentacionin që vërteton se janë përfitues, si rezultat i lëvizjes nga qendrat e tyre të banimit, me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave;
- e. Aktin e marrjes së tokës bujqësore në përdorim, nëse e disponojnë.

Subjektet e përcaktuara si bashkë-themeluese të ish-ndërmarrjes bujqësore, sipas vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, të ndryshuar, të cilat nuk janë pajisur me AMTP, për tokën bujqësore që kanë në përdorim faktik, të paraqesin në bashki dokumentacionin si më poshtë :

- a. Kërkesën për pajisjen me Aktin e Marrjes së Tokës bujqësore në Pronësi, për tokën që kanë marrë në përdorim nga komisionet e ndarjes së tokës;

- b. Dokumentacionin kadastral, hipotekor, arkivor apo gjyqësor që provon pronësinë mbi tokën bujqësore apo rrënjët e ullinjve para reformës agrare dhe qenien e tyre si themelues të ish-kooperativës apo ish-ndërmarrjes bujqësore;
- c. Planvendosjen e ngastrës/ave që subjekti përdor për qëllime bujqësore, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët;
- d. Çertifikatën e trungut familjar (përbërjen e familjes) në momentin e dorëzimit të tokës bujqësore dhe çdo dokument tjetër, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar;
- e. Aktin e marrjes së tokës bujqësore në përdorim, nëse e disponojnë.

Të gjithë përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, si dhe bashkëthemeluesit, që dëshirojnë të pajisen me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi kanë të drejtë të paraqesin gjithë dokumentacionin e sipërcituar pranë Bashkisë Korçë deri në datë **30.09.2017.**

**U afishua në datë** \_\_\_\_\_

**Administratori** \_\_\_\_\_

*emër, mbicmër, tirmë*

